



REPUELIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Priljeno: 03.12. 20 21		
Njësia Jednica	Numri Seri	Shtojca Dodatak
15-020-74477		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12, 51 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Udhëzimit administrativ nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme në Komunë si dhe nenit 20 par. 20.1, 33 dhe 35 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës kërkon nga Kuvendi i Komunës që në mbledhjen e datës _____ të miratojë këtë:

PROPOZIM

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

Neni 1

Me këtë Vendim themelohet Komiteti për Komunitete i Kuvendit të Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Komiteti për Komunitete ka mandat 4 vjeçar

Neni 3

Kryesuesi i Komitetit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të Komitetit për Komunitete.

Neni 4

Për anëtarë të Komitetit për Komunitete emërohen si vijon:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____
9. _____

Neni 5

Komiteti për komunitete në pajtim me dispozitat e nenit 53 par.53.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ka detyrë dhe përgjegjësi si vijon:

Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht.

Komiteti gjithashtu i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit faqen elektronike të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për ta miratuar këtë Propozim-Vendim është e përcaktuar me dispozitat e neneve 12, 51 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Udhëzimit administrativ nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme në Komunë si dhe nenit 20 par. 20.1, 33 dhe 35 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008.

Nga të cekurat më lartë propozojmë miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

15Nr. _____

Lipjan, më _____

KRYESUESI I KUVENDIT

Dan Azemi

